

KLSH merr pjesë në takimin e mbajtur për publikimin e Raportit të Përbashkët të Auditimit të Performancës me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”.

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në muajin shkurt 2023 përfundoi Auditimin e Performancës me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”. Ky auditim është kryer në kuadër të angazhimit që KLSH kishte me 6 (gjashtë) SAI të tjera si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Turqia dhe Sllovakia. Auditimi u drejtua nga SAI-i i Maqedonisë së Veriut.

Në përfundim të auditimeve individuale nga secili SAI, në muajin korrik 2023 u publikua dhe raporti i përbashkët i auditimit.

SAI i Maqedonisë së Veriut si drejtues i këtij projekti organizoi një takim me rastin e përfundimit të këtij angazhimi.



Takimi u zhvillua në Shkup më datat 26-27 shtator 2023 KLSH u përfaqësua nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Alfred Zylfi dhe grupi i auditimit znj. Ermira Vojka, z. Albert Hoxhalli dhe z. Redi Ametllari.

Në ditën e parë takimi ishte i organizuar me prezantime të rezultateve të auditimit nga secili SAI pjesëmarrës. Nga KLSH prezantoi rezultatet e auditimit znj. Ermira Vojka.

Foto: Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë së Veriut

Në ditën e dytë, u prezantuan çështjet kryesore nga raporti i përbashkët, si dhe dy prezantime nga dy profesorë të Fakultetit të Ekonomisë në Shkup. Prezantimet lidheshin me performancën e institucioneve të pushtetit vendor në Maqedoni të Veriut por dhe krahasime me vendet e tjera të rajonit apo Evropës, si dhe me financimet që lidhen me ndryshimet e klimës.



Foto: Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë së Veriut